



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 06.02.2012, në orën 13:00.
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Blerta Deliu – Kodra, Alma Lama, Blerim Shala, Suzana Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Vjosa Osmani,.

Stafi mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha, Safet Beqiri dhe Adelina Demolli.

Pjesëmarrës të tjerë: Venera Mjekiqi- Kuvend, Lejla Selimi- OSBE, Besim Zeqiri- ICO.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri, kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.01.2012;
3. Shqyrtimi i Projektligjit 04/L-46 për Transmetuesin Publik në Kosovë, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-98 për Deminim humanitar me amendamentet e

Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-76 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
9. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.01.2012.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 24.01.2012 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari - E ftoi deputeten Alma Lama, referuese e Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Alma Lama – Tha se pas vërejtjeve të bëra nga Komisioni Evropian, Komisioni Funksional ka marrë në shqyrtim edhe një herë këtë projektligj dhe ka inkorporuar vërejtjet e dhëna nga Komisioni Evropian. I vetmi amendament i cili nuk është inkorporuar është ai sa i përket përqindjes së buxhetit vjetor për RTK-ën. Komisioni Evropian ka kërkuar që buxheti vjetor për RTK-ën të jetë 0.7% ndërsa Komisioni Funksional ka kërkuar që ky buxhet të jetë 0.9%. Andaj, kërkoi që për këtë çështje të bëhet amendament dhe të kërkohet që buxheti vjetor i RTK-ës të jetë 0.7% ashtu edhe siç është paraparë me Ligjin për Buxhetin e Kosovës.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

Përfundim

Projektligji 04/L-46 për Transmetimin Publik në Kosovë, me amendamentet e Komisionit Funksional, si dhe amendamentin e Komisionit për Integritet Evropian, është në harmoni me Acquis Communautaire

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari - E ftoi deputeten Alma Lama, referuese e Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Alma Lama – Tha se edhe për këtë projektligj, pas vërejtjeve të bëra nga Komisioni Evropian, Komisioni FunkSIONAL ka marrë në shqyrtim edhe një herë këtë projektligj dhe ka inkorporuar vërejtjet e dhëna nga Komisioni Evropian.

Propozoi që në amendamentin 16, neni 31, pas fjalisë “Ndalohej vendosja e produktit” të shtohet fjalia “***në kanalet e transmetuesit publik***”, si dhe në pikën 2.1 pas fjalës ***audiovizuale*** shtohet fjala ***komerciale***.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri e nxori këtë:

Përfundim

Projektligji për Komisionin e Pavarur të Mediave, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, si dhe amendamentin e Komisionit për Integritet Evropian, është në harmoni me Acquis Communautaire

5. Shqyrtimi i Projektligjit për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari - E ftoi deputeten Suzana Novoberdali, referuese e Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Suzana Novoberdali- Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni një zëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL, është në harmoni me Acquis Communautaire.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare me amendamentet e Komisionit FunkSIONAL nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari - E ftoi deputeten Suzana Novoberdali, referuese e Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Suzana Novoberdali- Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni një zëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

7. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-98 për Deminim humanitar me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari - E ftoi deputetin Albert Kinolli, referuese i Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Albert Kinolli - Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni një zëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji Nr. 04/L-98 për Deminim humanitar, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

8. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 04/L-76 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës me amendamentet e Komisionit Funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

Kryetari - E ftoi deputeten Blerta Deliu-Kodra, referuese e Projektligjit, ta paraqesë raportin për këtë projektligj.

Blerta Deliu-Kodra - Pas shqyrtimit konstatuam se ky Projektligj, së bashku me amendamentet e Komisionit Funksional, nuk është në kundërshtim me legjislacionin e përgjithshëm të BE-së dhe mund të kalojë për miratim në procedurë të rregullt parlamentare.

Kryesuesi konstatoi se Komisioni një zëri e nxori këtë

Përfundim

Projektligji Nr. 04/L-76 për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës, me amendamentet e Komisionit Funksional, është në harmoni me Acquis Communautaire.

9. Të ndryshme.

Xhavit Haliti - Tha se ne kemi problem me pensionet si për ligjin për deputetet edhe për kategoritë e tjera, sepse të garantojmë me ligj pensione pa paguar kontribute është çështje që duhet të analizohet. Nëse këta njerëz nuk kanë paguar kontribute ose nëse Qeveria nuk ka ndarë një buxhet për të paguar kontribut është e pamundur të realizohet. Duhet të gjejmë një mënyrë për të gjetur zgjidhje për këtë problem. Këtë çështje duhet ta shqyrtojnë edhe Komisioni për Buxhet edhe Qeveria e institucionet e tjera dhe të shihet nëse ekziston mundësia që të sigurohet pensioni pa paguar kontributet.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri